

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7927
E shtunë, 9 nëntor 2024
Çmimi 0.50

Semiopragmatizmi vital i Shkëlzen Ukëhaxhajt



SHKRUAN: EMINE BORIÇI - LUSHNJË, SHQIPËRI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

JUDAH: KTHIMI I GRENELLIT MUND TË SJELLË SHQETËSIME PËR QEVERINË E KOSOVËS

FAQE 4-5



Ende pa u rikthyer në Shtëpinë e Bardhë, analistë dhe vëzhgues të shumtë shtrojnë gjithnjë e më shumë çështjen e pozicionimit të administratës së re amerikane, të presidentit Donald Trump, lidhur me vatrat aktuale të krizës në botë, pa

përjashtuar rajonin e Ballkanit. Analisti britanik Tim Judah thotë për "Radion Evropa e Lirë" se është herët të flitet për këtë për shkak se kjo do të varet nga ata që do të emërohen në detyra të caktuara. Rikthimi eventual i Richard Grenellit, i

cili gjatë administratës Trump ishte përfaqësues amerikan në dialogun Kosovë - Serbi, do të ishte me ndikim të rëndësishëm dhe për këtë, sipas tij, qeveria në Prishtinë mund të ketë arsye për t'u shqetësuar

BIDENI GARANTON SE DO TË KETË TRANSFERIM PAQËSOR TË PUSHTETIT

F.3



NË SAMITIN E KOMUNITETIT POLITIK EVROPIAN, OSMANI KËRKON MBËSHTETJE PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KIE

F.3



RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

FITORJA E TRUMPIT, NJË FILLIM I RI PËR AMERIKËN

F.6

Shkruan: Faton
MEHMETAJ



NË EPOKËN DIGJITALE, FAQET ZYRTARE TË PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË NGJASOJNË ME ATO TË VENDEVE KOMUNISTE

F.5

Astrit GASHI



AKTUALE



BUJA THOTË SE SPECIALJA KA PËRFUNDUAR HETIMET NDAJ

F.5

EKONOMI



BUJQIT NË HALL ME NORMAT E LARTA PËR KREDI NGA INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE

F.7

TELEKOMI I KOSOVËS THOTË SE "VALA" KA MODIFIKUAR PAKOT, MOHON SE JANË SHTRENJTUAR

Bideni garanton se do të ketë transferim paqësor të pushtetit

WASHINGTON, 8 NËNTOR - Presidenti amerikan Joe Biden, në deklarimin e parë publik qëkur republikani Donald Trump fitoi zgjedhjet presidenciale të Shteteve të Bashkuara, garantoj se do të ketë transferim paqësor të pushtetit, duke shtuar se kjo do të bëhet "sepse njerëzit e meritojnë këtë". Kjo deklaratë duket se ishte një referencë për Trumpin, i cili kishte tentuar ta përmbyste humbjen e tij kundër Bidenit më 2020 dhe kishte ngritur pretendime të pabaza për mashtrime zgjedhore. Trumpi atëbotë nuk ishte marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Bidenit si president. "Kthimet

prapa janë të pashmangshme. Të heqësh dorë është e pafalshme", tha Biden nga Shtëpia e Bardhë teksa iu drejtua stafit të zhgënjyer nga humbja në zgjedhje e nënpresidentes demokrate, Kamala Harris. "Disfata nuk do të thotë se je mposhtur", tha Biden. Presidenti amerikan tha se zgjedhjet e 5 nëntorit dëshmuar integritetin e sistemit zgjedhor amerikan. "Ne humbëm këtë betejë. Amerika e ëndrrave tuaja po ju kërkon që të ngriheni sërish në këmbë", tha Biden. Ai, po ashtu, tha se "do të jemi mirë, por duhet të mbesim të angazhuar".

Disa demokratë e kanë fajësuar Bidenin për humbjen e Harrisit, duke thënë se ai nuk është dashur ta synonte rizgjedhjen. Bideni u tërhoq nga synimi i tij për rizgjedhje në korrik, pas një paraqitjeje të dobët në debatën me Trumpin, që ngriti dyshime për aftësinë e tij për ta mposhtur Trumpin. Ekipi i Trumpit ka thënë se Bideni e ka ftuar atë të takohet në Shtëpinë e Bardhë, por nuk kanë specifikuar ndonjë datë për këtë takim. Një ditë më parë Harris pranoi humbjen dhe sikurse Bideni, ajo premtoi se do të ketë transferim paqësor të pushtetit, teksa Trumpi do të inaugurohet si presidenti i 47 i



ShBA-së më 20 janar 2025. Bideni vazhdojë luftën për atë që Harris pranoi se do ta beson.

OKB: Gati 70 % e të vdekurve nga lufta në Gazë janë gra dhe fëmijë

NJU-JORK, 8 NËNTOR - Zyra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ka thënë të premten se gati 70 për qind e viktimave që i ka verifikuar në luftën e Gazës janë gra dhe fëmijë, duke thënë se e dënon shkeljen sistematik të parimeve themelore të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar. Gjetjet e OKB-së mbulojnë shtatë muajt e parë të luftës në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga ShBA dhe BE - në Rripin e Gazës, e cila nisi para më shumë se një viti. Zyra e OKB-së i verifikoi 8 119 viktima gjatë shtatë muajve të



parë të luftës, por kjo shifër është jashtëzakonisht e ulët krahasuar me numrin e përgjithshëm të të

vrarëve, mbi 43 000, gjatë 13 muajve luftë, sipas Ministrisë palestineze të Shëndetësisë.

Megjithatë, verifikimi i moshës dhe gjinisë së viktimave nga OKB-ja mbështet pohimet e palestinezëve se shumica e të vrarëve në luftë janë gra dhe fëmijë. Këto gjetje tregojnë "për një shkelje sistematike të parimeve themelore të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar", tha zyra e OKB-së në një komunikatë. Izraeli nuk i ka komentuar ende gjetjet e raportit 32-faqesh të OKB-së. Ushtria izraelite, e cila e nisi luftën në Gazë si përgjigje ndaj sulmit të 7 tetorit 2023, pasi luftëtarët e Hamasit i vranë rreth 1 200 njerëz në jug të Izraelit dhe

i rrëmbyen më shumë se 250 të tjerë, thotë se kujdeset që të mos i dëmtojë civilët në Gazë. Për vrasjen e civilëve ajo e fajëson Hamasin, duke e akuzuar atë se i përdor ata si mburojë njerëzore. Hamasi i ka mohuar akuzat se i përdor civilët dhe infrastrukturën civile, përfshirë spitalet, si mburoja njerëzore. Viktima më e re, vdekja e të cilit u verifikua nga vëzhguesit e OKB-së, ishte një djalë njëditësh, ndërsa më e vjetra ishte një grua 97-vjeçare, thuhet në raport. Në total, 44 për qind e viktimave ishin fëmijë.

Erdogani: Shpresoj se Trumpi do t'i thotë Izraelit ta ndalë luftën

ANKARA, 8 NËNTOR - Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka thënë të premten se shpreson se presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do t'i thotë Izraelit ta "ndalë" luftën. Ai tha se një "fillim i mirë" do të ishte duke e ndërprerë furnizimin e Izraelit me armë nga ShBA-ja. "Trumpi ka dhënë premtime për t'u dhënë fund konflikteve... ne duam që ai t'i mbajë këto premtime dhe që t'i thotë Izraelit 'ndalu'", tha Erdogan për gazetarë duke u kthyer nga Budapesti. "Fillim i mirë do të ishte që Trumpi ta ndërpresë mbështetjen me armë për Izraelin, në mënyrë që të ndalet agresioni i Izraelit në tokat palestineze dhe libaneze", tha ai. Turqia i ka kritikuar ashpër ofensivat ushtarake të Izraelit

në Rripin e Gazës dhe në Liban, si dhe e ka ndërprerë tregtinë me Izraelin. Ajo, gjithashtu, i është bashkuar një rasti për gjenocid kundër Izraelit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë. Presidenca e Trumpit do të ketë ndikim të madh ndaj balancave politike dhe ushtarake në Lindjen e Mesme, tha Erdogan, duke shtuar se mbajtja e qëndrimeve të tanishme amerikane do ta thellojë dhe zgjerojë konfliktin. Izraeli është duke luftuar kundër Hamasit - grupit të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE ja - tash e një vit. Lufta, e cila ka lënë mbi 43 000 të vdekur sipas autoriteteve shëndetësore palestineze, u nxit nga një sulm i Hamasit në Izrael më 7 tetor 2023. Në atë sulm, luftëtarët e



Hamasit i vranë rreth 1 200 njerëz në jug të Izraelit dhe i rrëmbyen më shumë se 250 të tjerë, sipas autoriteteve izraelite. Konflikti midis Izraelit dhe Hezbollahut shpërtheu një vit më parë kur grupi i mbështetur nga Irani filloi të hidhte raketa në veri të Izraelit në mbështetje të Hamasit. Në muajt e fundit konflikti është përshkallëzuar, pasi Izraeli

është duke bombarduar paseshtur jugun e Libanit, periferitë jugore të Bejrutit dhe Luginën Beka, duke vrarë shumë nga udhëheqësit kryesorë të Hezbollahut dhe duke dërguar trupa tokësore përtej kufirit. Nga ana e tij, Hezbollahu ka hedhur raketa më thellë brenda Izraelit. Hezbollahu, i cili e kontrollon

Libanin jugor, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka vendosur në listën e zezë krahun e tij të armatosur, por jo edhe partinë e tij politike. Izraeli thotë se lufta e tij në Liban synon ta bëjë veriun e Izraelit të sigurt për dhjetëra mijëra njerëz që janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre gjatë vitit të fundit si pasojë e sulmeve raketore nga Hezbollahu. Operacioni i zgjeruar i Izraelit i ka zhvendosur më shumë se 1.2 milion njerëz, sipas qeverisë libaneze, e cila thotë se më shumë se 2 500 njerëz janë vrarë dhe më shumë se 10 000 janë plagosur gjatë një viti luftimesh. Raketat e Hezbollahut kanë vrarë të paktën 54 njerëz në Izrael, më shumë se gjysma e tyre civilë, sipas autoriteteve izraelite.

Haradinaj pret në takim presidentin e "Vatrës", kërkon angazhimin e tij për Kosovën

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Në selinë e AAK-së, kryetari Ramush Haradinaj ka pritur në takim presidentin e Federatës Pan-shqiptare "Vatra", Elmi Berisha, të cilin e ka falënderuar për angazhimin dhe kontributin e madh që po ofron në mbështetje të Republikës së Kosovës dhe kauzave kombëtare. "Z. Berisha, si udhëheqës i Federatës pan-shqiptare "Vatra", tashmë në mandatin e tij të dytë, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në sensibilizimin e agjendës së Kosovës, veçanërisht në ndërtimin e marrëdhënieve me vendimmarrësit në Uashington, si dhe në Kongres dhe Senat. Kërkova nga z. Berisha që këtë




përkushtim ta shtojë edhe më tej, duke ndihmuar agjendën e integritetit direkt të Kosovës në

NATO përmes Planit Aksional për Anëtarësim", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Aktakuzë kundër 26 zyrtarëve policorë, të dyshuar për "Marrje ryshfeti" në pikën kufitare Vërmicë

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur të premtën aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, kundër të pandehurve A.K., B.H., B.P., B.O., B.S., D.Z., F.H., F.R., H.S., H.H., I.I., I.S., K.S., M.S., N.H., N.S., R.M., R.K., R.G., S.K., S.Q., S.P., S.H., S.H.A., S.H.SH., Z.P. Të gjithë të pandehurit akuzohen se në cilësi të zyrtarëve policorë, me detyrë në SMPK - Pika Kufitare Vërmicë, me veprimet e tyre kane kryer veprën penale "Marrja e ryshfeti".



Në Samitin e Komunitetit Politik Evropian, Osmani kërkon mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në KiE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka takuar kryeministrin e ri të Estonisë, Kristen Michal, në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik Evropian.

Osmani në "Facebook" ka shkruar se me kryeministrin estonez kanë folur për anëtarësimin e Kosovës në Këshill të Evropës. "Ishte kënaqësi të takoj kryeministrin e ri të Estonisë, z. Kristen Michal. Në kuadër të samitit të Komunitetit Politik Evropian, diskutuam për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, heqjen e masave të BE-së ndaj Kosovës, si dhe për shtyrjen përpara të aplikacionit të Kosovës për anëtarësim në BE. Falënderuese për mbështetjen e fuqishme të Estonisë!", ka shkruar Osmani.

Osmani ka takuar edhe kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar, Keir Starmer. "Bashkëpunimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe marrëveshja e arritur së fundmi mes dy vendeve tona në fushën e emigracionit, ishin në fokus të diskutimit me kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar, Keir



Starmer. Kosova është mirënjohëse për mbështetjen e palëkundur të Mbretërisë së Bashkuar", ka shkruar presidentja Osmani.

Ajo ka njoftuar edhe për takimin

që ka pasur me kryeministrin e Letonias, Evika Siliņa, shtet ky që, sipas Osmanit, është një partner i fuqishëm i Kosovës, duke përkrahur jo vetëm shtetndërtimin, por edhe

përpjekjet tona për integrimin euroatlantik. "Me kryeministrin Evika Siliņa, biseduam për përkushtimin tonë të palëkundur për të avancuar në rrugën tonë evropiane, me theks të veçantë

për anëtarësimin e Kosovës në KiE, heqjen e masave ndaj Kosovës, si dhe për ecjen përpara me statusin e kandidatit për vendin tonë", ka theksuar Osmani.

Së shpejti në duart e lexuesve libri i Burim Ramadanit "Në luftë hibride"

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, ish-inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës, eksperti i sigurisë, Burim

Ramadani, ka paralajmëruar në "Facebook" se shumë shpejt do të jetë në duart e lexuesve libri i tij "Në luftë hibride".

Ai ka treguar se ky libër po

vjen pas një pune njëvjeçare të një periudhe sfiduese. "Shumë shpejt do të jetë në duart e lexuesve. I lumtur që po bëhet gati libri. Shumëçka do të jetë e

veçantë dhe tema diskutimi edhe publik. Një punë gati 1-vjeçare në përmbledhje të një periudhe sfiduese", ka shkruar Ramadani.





Judah: Kthimi i Grenellit mund të sjellë shqetësime për Qeverinë e Kosovës

“Nuk mendoj se z. Trump ka menduar ndonjëherë për Ballkanin. Ka disa njerëz rreth tij, si Richard Grenell, të cilët sigurisht se kanë menduar për Ballkanin. Ajo që do të ndodhë, varet nga ata që do të emërohen në detyra të caktuara. Për shembull, a do të kthehet Richard Grenell, i cili luajti një rol të rëndësishëm më parë? A do të jetë sërish me ndikim? Në atë rast, mendoj se ndoshta ka arsye për t’u shqetësuar, veçanërisht për qeverinë në Prishtinë”, ka theksuar për “Radion Evropa e Lirë” analisti britanik Tim Judah

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ende pa u rikthyer në Shtëpinë e Bardhë, analistë dhe vëzhgues të shumtë shtrojnë gjithnjë e më shumë çështjen e pozicionimit të administratës së re amerikane, të presidentit Donald Trump, lidhur me vatrat aktuale të krizës në botë, pa e përjashtuar këtu edhe rajonin e Ballkanit.

Analisti britanik Tim Judah thotë për “Radion Evropa e Lirë” se është herët të flitet për këtë për shkak se kjo do të varet nga ata që do të emërohen në detyra të caktuara.

Rikthimi eventual i Richard Grenellit, i cili gjatë administratës Trump ishte përfaqësues amerikan në dialogun Kosovë - Serbi, do të ishte me ndikim të rëndësishëm dhe për këtë, qeveria në Prishtinë mund të ketë arsye për t’u shqetësuar, thotë ai.

Judah shpreh skepticizëm për mundësinë që administrata e re Trump të arrijë një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: “Trumpi u përpoq edhe më parë. Kishte një nënshkrim të famshëm në Uashington për dy marrëveshje të veçanta, por asgjë e madhe nuk doli prej tyre”, shprehet Judah në intervistën për REL.

Cilat mendoni se do të jenë prioritetet e mundshme të administratës së re të presidentit Trump për Ballkanin Perëndimor?

Tim Judah: Nuk mendoj se z. Trump ka menduar ndonjëherë për Ballkanin. Ka disa njerëz rreth tij, si Richard Grenell, të cilët sigurisht se kanë menduar për Ballkanin. Ajo që do të ndodhë, varet nga ata që do të emërohen në detyra të caktuara. Për shembull, a do të kthehet Richard Grenell, i cili

luajti një rol të rëndësishëm më parë? A do të jetë sërish me ndikim? Në atë rast, mendoj se ndoshta ka arsye për t’u shqetësuar, veçanërisht për qeverinë në Prishtinë.

Nëse e pyesni Trumpin sot, cilat janë prioritetet tuaja në Ballkan, mendoj se ai ndoshta nuk do të kishte ide, ndoshta do të kishte vështirësi edhe për ta gjetur Ballkanin në hartë, pra nuk mendoj se Ballkani është në listën e çështjeve të tij kryesore. Megjithatë, ai duhet të emërojë persona që do të hartojnë politika dhe të merren me pjesën tjetër të botës. Le të shohim se kë do ta caktojë.

A mendoni se administrata e re e Trumpit do të jetë në gjendje të arrijë një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?

Tim Judah: Mendoj se nuk ka gjasa, sepse në fund të ditës

duhet të ketë vullnet politik në Kosovë dhe në Serbi, apo në qeveritë e tjera paraprake të Kosovës dhe Serbisë. Aktualisht, nuk mendoj se ka ndonjë vullnet politik për ta bërë këtë, pra nuk ka shumë rëndësi. Dua të them, po, sigurisht, është e rëndësishme nëse amerikanët dhe evropianët janë të bashkuar dhe mbështesin një formë zgjidhjeje. Fakt është se ata kanë qenë të bashkuar edhe në vitet e fundit, por problemi ka qenë te mungesa e vullnetit politik në Beograd dhe në Prishtinë. E dini, z. Trump u përpoq më parë. Kishte një nënshkrim të famshëm në Uashington për dy marrëveshje të ndara, por asgjë e madhe nuk doli prej tyre. Kështu që nuk jam i sigurt nëse do të ketë ndryshime në administratën e dytë të Trumpit.

Megjithatë, vëzhguesit nuk e përjashtojnë mundësinë e një konfrontimi tjetër të lokalizuar në veriun e Kosovës për të arritur një marrëveshje përfundimtare ndërmjet dy shteteve. Cfarë mendoni?

Tim Judah: Kjo tingëllon si një teori konspirative. Nuk besoj se dikush në Uashington do të pajtohej që të ketë një lloj konfrontimi në veri për të arritur një marrëveshje. Nuk

pajtohem me këtë. Mendoj se do të ketë një marrëveshje për veriun e Kosovës kur të ketë vullnet politik për ta bërë këtë, në Prishtinë dhe në Beograd.

Me presidentin Trump, a prisni ulje të tensioneve në Mal të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë për shkak të ndikimit serbo-rus?

Tim Judah: Mendoj se është shumë herët. Do të varet nga ata që do të emërohen në pozicione të caktuara në administratë. Mendoj se ka njerëz që mendojnë, ndoshta me të drejtë, se disa nga njerëzit e Trumpit, përsëri po e përmend z. Grenell, kanë qenë qartësisht proserbë. Nëse Grenelli, për shembull, kthehet në një pozicion të rëndësishëm në Shtëpinë e Bardhë ose në administratën e re, po - atëherë ka arsye për t’u shqetësuar në Kosovë dhe në Bosnjë. Po ritheksoj, ende nuk e dimë se kush çfarë do të bëjë në administratën e ardhshme.

Duke qenë se po flasim për këto çështje në Maqedoninë e Veriut, çfarë mund të presim nga administrata e re e ShBA-së për të ndihmuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Bullgarinë, veçanërisht për përfshirjen e bullgarëve në Kushtetutë?

Në epokën digjitale, faqet zyrtare të partive politike në Kosovë ngjasojnë me ato të vendeve komuniste

Astrit GASHI

Vizita në faqet zyrtare të partive kryesore në Kosovë, si Vetëvendosje (VV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) etj., tregon një problem të theksuar: mospërditësimi i përmbajtjes, mungesa e dokumenteve kyçe dhe qasja e ngurtë që krijon një atmosferë të epokës së komunizmit, ku përqendrimi është kryesisht te lideri dhe jo te programi apo strategjitë konkrete. Ky është një kontrast i madh me qasjen



që partitë politike në një vend demokratik duhet të kenë për të tërhequr dhe angazhuar qytetarët, veçanërisht në prag të zgjedhjeve. Përmbajtja e papërditësuar dhe

mungesa e qartësisë në faqe e japin përshtypjen se këto parti nuk kanë programe të mirëpërcaktuara apo struktura të organizuara të komunikimit. Një faqe zyrtare e mirëmbajtur dhe e përditësuar është pasqyrë e organizimit të partisë dhe tregon përkushtim ndaj transparencës dhe lidhjes me publikun. Publikimi i dokumenteve kyçe, si statutet, programet dhe strategjitë, është jo vetëm një kërkesë ligjore, por edhe një mjet i rëndësishëm për të fituar besimin e qytetarëve dhe për të forcuar ndjenjën e përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse.

Në një epokë të komunikimit digjital, partitë politike në Kosovë duhet të përqendrohen më shumë në profesionalizmin e tyre digjital. Përditësimi i rregullt i informatave, qasja e lehtë dhe dizajni i qartë janë elemente thelbësore që ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e qytetarëve. Pa këto elemente, rrezikohet të krijohet përshtypja se partitë janë të prapambetura dhe të shkëputura nga realiteti dhe nevojat e qytetarëve të tyre. Me këtë qasje dhe me migrim të madh të popullsisë në zgjedhjet e 9 shkurtit nuk do të dalin më shumë se 30 % e popullsisë!

Buja thotë se Specialja ka përfunduar hetimet ndaj tij

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Shukri Buja, tha se Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë e ka liruar nga të gjitha akuzat dhe ka përmbyllur hetimet ndaj tij.

Buja, ish-kryetar i Lipjanit, tha se hetimet ndaj tij, që nisën më 2019, u përmbyllën dhe ai u njoftua zyrtarisht për këtë gjatë kësaj jave nga Dhoma e Specializuar.

“Kam kënaqësinë t’ju njoftoj se pas një procesi të gjatë hetimor që zgjati mbi pesë vjet prej 2019-s, më në fund jam liruar nga të gjitha akuzat e Prokurorisë Speciale të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë! Kjo është një fitore e madhe dhe e rëndësishme, e cila vërteton pafajësinë time dhe pastërtinë dhe lavdinë e UÇK-së. Falë avokatëve të mi, Sir Geoffrey Nice dhe Taulant Hodaj, dhe insistimit të tyre për t’i mbyllur hetimet për mungesë provash, këtë javë mora konfirmimin zyrtar që gjithçka është mbyllur përfundimisht. Ky është rasti i parë i mbyllur për veprat

penale të krimeve të luftës të hetuara nga kjo Prokurori në mënyrë zyrtare. Besoj se ky rast imi do të kontribuojë që drejtësia ta thotë fjalën e fundit për bashkëluftëtarët tanë ende gjenden në Hagë dhe shpresoj që edhe ata të kthehen faqebardhë dhe fitimtarë sa më shpejt. Lufta jonë, si popull, ka qenë një përpjekje e drejtë dhe legjitime për liri kundër okupatorit serbo-jugosllav, i cili ka kryer krime të rënda ndaj popullit tonë. Lufta jonë çlirimtare ishte e imponueshme dhe e drejtë”, ka shkruar Buja, duke shtuar se ky realitet u vërtetua nga rasti i tij. “Shpresoj se do të vërtetohet gjithashtu edhe nga rasti i bashkëluftëtarëve tanë që po përballen ende me proceset në Hagë. Një falënderim i veçantë shkon për familjen time për mbështetje të palëkundur gjatë këtyre viteve, për qytetarët e Republikës së Kosovës që më mbështetën dhe më besuan, si dhe për avokatët e mi për angazhimin dhe kontributin e tyre të pandërprerë deri në epilogun e këtij rasti”, ka shkruar Buja.



Tim Judah: Nuk jam plotësisht i sigurt pse një administratë e re duhet të jetë ndryshe nga ajo e mëparshme në këtë drejtim? Nuk e kuptoj pse. Mendoj se nuk ka arsye që ata të mos vazhdojnë me të njëjtën politikë dhe të përpiqen ta bindin qeverinë të bëjë atë që është e nevojshme. Megjithatë, nuk jam i bindur se do të ketë ndonjë ndryshim të madh në politikë. Nuk shoh arsye. Dhe, mendoj se problemi nuk është vetëm këtu; është gjithashtu paqëndrueshmëria politike në Bullgari pas shtatë palë

zgjedhjeve në vitet e fundit. Ka probleme këtu, ka probleme gjithashtu edhe në Bullgari. Çështje të tilla, veçanërisht ajo e Bullgarisë, nuk lidhen me amerikanët dhe nuk kanë të bëjnë me asgjë që ata mund të ndikojnë. Kështu që, nuk shoh arsye pse të ketë ndryshim në këtë aspekt në lidhje me Maqedoninë e Veriut.

Krejtësisht në fund, si mendoni se do të ndikojë politika e jashtme e Trumpit në Ukrainë dhe në krizën aktuale atje, veçanërisht duke marrë

parasysh angazhimet e tij të mëparshme me Rusinë dhe qëndrimet e tij për NATO-n?

Tim Judah: Trumpi ka deklaruar triumfalisht se mund ta përfundojë luftën në Ukrainë brenda 24 orëve. Ndërsa J. D. Vance, i përfolur si zëvendëspresident i mundshëm, ka thënë se zgjidhja duhet të përfshijë që Ukraina të heqë dorë nga territoret e humbura dhe të mos anëtarësohet në NATO, gjë që nënkupton mungesë të garancive të sigurisë - diçka që ukrainasit me siguri nuk do ta

pranonin. Ata mund të detyrohen të pranojnë nëse Trump vendos të ndërpresë furnizimin me armë dhe municione për Ukrainën, por përsëri është herët për të nxjerrë përfundime, sepse ka shumë forca brenda Partisë Republikane që përfundimisht nuk duan ta braktisin Ukrainën dhe do të donin të përballëshin me Rusinë. Vendimi, pra, nuk do të jetë plotësisht në dorën e Trumpit. Sigurisht, ai është padyshim lojtari kryesor në çështjen e Ukrainës, por jo i vetmi. Për

më tepër, Trump është i paparashikueshëm. Është si me financat.

Ju shihni reklama për investime dhe thuhet, të paktën në Britani, performanca e kaluar nuk është udhëzues për të ardhmen. Dhe, mendoj se kjo mund të thuhet edhe për Trumpin. Performanca e kaluar dhe gjërat që ai ka thënë në të kaluarën mund të mos jenë udhëzues për të ardhmen. Prandaj, le të shohim. Fatkeqësisht, ende nuk e dimë. Është shumë herët.

Administrata e re me fitoren e Trumpit si president i ShBA-së: A do të përshpejtohet integrimi i Kosovës në strukturat ndërkombëtare?



Nga Filadelfia, Pennsylvania, SHBA.
Shkruan: Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Për shkak të fitimit të zgjedhjeve (rikthimit) të Donald Trump si president, mund të ketë ndryshime në politikën e tij ndaj integritetit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Politika e tij mund të përfshijë intensifikimin e përpjekjeve për të integruar Kosovën në strukturat si Kombet e Bashkuara (OKB) dhe organizatat tjera ndërkombëtare, megjithatë kjo do të varet nga dinamika politike dhe prioritetet gjatë mandatit të tij të dytë. Ja disa mundësi të mundshme: Trump mund të shfrytëzojë ndikimin diplomatik të ShBA-së për të lobuar për njohjen e Kosovës nga shtetet që ende nuk e kanë bërë, duke përfshirë disa vende të BE-së dhe shtete tjera strategjike. Njohjet e reja mund të hapin mundësinë që Kosova të bëhet anëtare e plotë në organizatat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara. Kjo mund të përfshijë nxitjen e njohjeve nga shtete që janë të paqartë në lidhje me statusin e Kosovës, siç janë disa shtete të Azisë dhe Afrikës, përmes diplomacisë amerikane. Trump mund të fokusohet gjithashtu në forcimin e lidhjeve të Kosovës me NATO-n dhe OSBE-në, duke ofruar mbështetje për integrimin e Kosovës në këto organizata. Pjesëmarrja e Kosovës në partneritete me NATO-n, siç

është Programi i Partneritetit për Paqe, mund të mbetet një prioritet, ndërkohë që anëtarësimi i Kosovës në organizatat tjera ndërkombëtare mund të përshpejtohet nëse shihet si një avantazh për sigurinë rajonale. Pavarësisht se Trump mund të mbajë një qasje pragmatike ndaj dialogut Kosovë-Serbi, duke shmangur përpjekjet për njohje të menjëhershme, ai mund të inkurajojë procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare

përmes marrëveshjeve të avancuara, të cilat përqendrohen më shumë në bashkëpunimin ekonomik dhe të sigurisë, sesa në njohjen diplomatike të menjëhershme. Një mundësi tjetër është që Trump të vazhdojë të llojë për përfshirjen e Kosovës në Kombet e Bashkuara, duke përdorur ndikimin diplomatik të ShBA-së për të bindur shtetet që ende nuk e kanë njohur. Ky proces mund të mbetet sfidues për shkak të kundërshtimit të disa shteteve të fuqishme të OKB-së, por

mbështetja nga ShBA mund të ndihmojë për të tejkaluar barrierat. Në përgjithësi, politika e Trump në këtë fushë mund të jetë pragmatike, duke kërkuar përfitime konkrete në aspektin diplomatik dhe ekonomik për Kosovën dhe duke intensifikuar angazhimet për përfshirjen e Kosovës në organizatat ndërkombëtare nëpërmjet një qasjeje graduale dhe strategjike. Administrata e dytë e Trumpit për Kosovën dhe Ballkanin mund të përqendrohet në disa fusha

kyçe: Administrata Trump mund të vazhdojë të mbështesë projekte të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke u mbështetur në Marrëveshjen e Uashingtonit. Kjo mund të përfshijë zhvillimin e infrastrukturës që lidh Prishtinën dhe Beogradin, si autostradat dhe linjat hekurudhore, për të rritur tregtinë dhe zhvillimin ekonomik rajonal. Gjithashtu, Trump mund të inkurajojë investime amerikane për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e vendeve të punës. Në vend që të përqendrohet menjëherë te njohja e ndërsjellë, administrata Trump mund të promovojë marrëveshje praktike që forcojnë besimin, si përmirësimi i shërbimeve të ndërsjella, siç janë lidhjet ajrore direkte Prishtinë-Beograd. Kjo qasje mund të krijojë një klimë më të favorshme për zgjidhjen e çështjeve politike të ndërlikuara. ShBA mund të ruajë një rol ndërmjetësues të pavarur nga Bashkimi Evropian, siç u pa në Marrëveshjen e Uashingtonit. Kjo mund të përfshijë negociimin e marrëveshjeve të reja që ofrojnë përfitime afatshkurtra për rajonin dhe shmangin pengesat burokratike. Administrata Trump mund të promovojë investime në projekte energjetike që do të reduktojnë varësinë e Ballkanit nga Rusia, duke mbështetur energjinë e rinovueshme dhe gazsjellësin Trans-Adriatik, duke përmirësuar sigurinë energjetike dhe duke afruar rajonin me tregjet perëndimore. Një fokus tjetër mund të jetë reduktimi i ndikimit të Rusisë dhe Kinës në Ballkan përmes inkurajimit të investimeve perëndimore që ndihmojnë për zhvillimin ekonomik dhe politik të rajonit.



Fitorja e Trumpit, një fillim i ri për Amerikën



Shkruan: Faton MEHMETAJ

Kandidati i republikanëve për president të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i mposhti të gjitha sfidat dhe pengesat që i dolën gjatë fushatës zgjedhore sepse populli i ShBA-së ishte me të në zgjedhjet presidenciale i cili shënoi fitore vendimtare mes ndasive të thella në vend. Fitorja e republikanit Donald Trump pasqyron vlerat e demokracisë dhe fuqinë e vullnetit të lirë të qytetarëve të

tij dhe demokracisë së vërtetë. Ai me të drejtë fitoi mbështetjen e votuesve me premtimet e mëdha për ta përmirësuar ekonominë, bllokimin e fluksit të emigrantëve dhe thirrjes për ta bërë Amerikën përsëri madhështore. Kosova është aleatja më e ngushtë dhe më besnike e ShBA-së në rajon dhe në gjithë botë. Nën drejtimin e Donald Trumpit dhe të Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, Kosova do t'i kalojë të gjitha sfidat. Rritjes së importit të armëve të Serbisë nga Rusia, dhe zgjerimit të marrëdhënieve të saj me Moskën, do t'u ndërpritet hovi. Gjatë kësaj periudhe do të korrigjohen padrejtësitë ndaj Kosovës që ndodhën nga paaftësia e burokracive të Brukselit dhe faktorëve të tjerë. Kosovës do t'i kthehet shkëlqimi i dikurshëm. Administrata e presidentit

Donald Trump do ta vazhdojë mbështetjen diplomatike ndaj zgjidhjes së konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë, si domosdoshmëri për të dyja palët në përputhje të plotë me ligjet dhe politikën e ShBA-së. Fitorja e Donald Trumpit, presidentit të 47 të ShBA-së, është një fillim i ri për Amerikën, është fitore e aleancës së madhe për Kosovën. Përgëzime presidentit Trump për fitoren e madhe!

Hajdari: Industria e prodhimit luan rol të rëndësishëm

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, mori pjesë në hapjen e konferencës së 3-të Ndërkombëtare "Future Frames - Inteligjenca Artificiale në Arkitekturë dhe Evolucioni Urban", organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës. Në fjalën hyrëse, ministrja Hajdari theksoi se industria e prodhimit luan rol të rëndësishëm dhe të ndërlidhur në arkitekturë, ndërsa prodhimi është sektori me adoptimin e dytë më të lartë të inteligjencës artificiale, me ndikim të ndjeshëm në

zhvillimin dhe dizajnin e produktit, mirëmbajtjen e makinerisë, sigurimin e cilësisë, inspektimin e defekteve dhe automatizimin e linjave të prodhimit për t'i avancuar proceset e prodhimit. Ministria Hajdari njoftoi për vizionin e Qeverisë së Kosovës dhe objektivat strategjike të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) në shpalosjen e potencialit të industrisë prodhuese dhe inovacionit, për të kontribuar në mënyrë më efektive në zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Ajo

përmendi krijimin e Agjencisë për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve dhe krijimin e Fondit të Inovacionit, si një mekanizëm për mbështetjen e inovacionit në sektorë të ndryshëm industrialë prodhues dhe kreativë, përfshirë arkitekturën. Duke i dhënë rëndësi rritjes së bashkëpunimit në mes të industrisë dhe akademisë, ministrja Hajdari theksoi investimet kapitale në vazhdim nga MINT për zgjerimin e hapësirave fizike për subjektet dhe individët që kryejnë aktivitete inovative dhe



zhvillimin e ekosistemit inovativ përmes ndërtimit të inkubatorëve të biznesit dhe qendrave të inovacionit dhe

ndërmarrësisë në kuadër të universiteteve publike dhe pronave të tjera institucionale në Kosovë.

Bujqit në hall me normat e larta për kredi nga institucionet mikrofinanciare

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Institucionet mikrofinanciare po tregohen mjaft "dorështrenguar" në raport me fermerët të cilët në të shumtën e rasteve kanë vështirësi për qasje në financa për mungesë të garancive që kërkojnë bankat komerciale. Me gjithë këto kushte të vështira dhe norma të larta deri 19.2 për qind ose trefish më të larta se kamatat në bankat komerciale, fermerët dhe të tjerët nuk u ndalën në marrjen e kredive.

Nga janari deri në shtator institucionet mikrofinanciare dhe financiare jobankare kanë pasur fitim të pastër 15 milionë e 200 mijë euro.

Fermeri Xhemë Krasniqi, i cili merret me bujqësi tash e shumë vjet, rrëfen për "KosovaPress" sfidat që po hasin për të 'mbijetuar' në këtë sektor. Madje për të mos hequr dorë nga kjo veprimtari, ai thotë se pak kohë më parë janë detyruar të marrin kredi në një institucion mikrofinanciar për t'i mbuluar shpenzimet karshi nevojave të tregut. Ai derisa tregon se kanë marrë kredi 15 mijë euro, thotë se janë të detyruar të kthejnë rreth 6 mijë euro më shumë. "Ne merremi me blegtori, e dorëzojmë qumështin te një qumështore. Kredi kemi në 'Finca', 15 mijë



euro i kemi marrë aty, diku për 5 vjet do t'i kthejmë rreth 6 mijë euro më tepër. Ato i kemi marrë para pak kohe, na duhen për të mbjellë grurin, na duhen për naftë, farë, për të gjitha, dhe i kemi shtuar edhe dy krerë lopë", thotë Krasniqi. Më tej Krasniqi thotë se kamatat për bujqit janë shumë të larta, derisa ka kërkuar edhe

ndihmën e shtetit në këtë drejtim.

"KosovaPress" ka verifikuar edhe në njërin prej institucioneve mikrofinanciare për normat e kredive. Të njëjtit thonë se maksimumi i kredisë për bujqësi është deri në 25 mijë euro, duke theksuar se kohëzgjatja e kthimit është për 60 muaj apo 5 vjet, me këst 580

euro.

Në anën tjetër, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, thotë se normat e kredive për bankat dhe jobankat, në përgjithësi janë mbi mesataren e rajonit. "Normat e kredive për bankat dhe jobankat pak a shumë e kanë ndjekur trendin paraprak. Në përgjithësi ato janë mbi

mesataren e rajonit. Pra, nëse e shikon në rajon ka banka që kanë kamata më të larta se Kosova, ka që kanë më të ulëta por, megjithatë, mesatarja e Kosovës është ende mbi mesataren e rajonit", ka thënë ai.

Ndërsa Kujtim Sahitaj, udhëheqës i marketingut, Departamenti i Marketingut në Kreditimin Rural të Kosovës (KRK), duke folur për kërkesat, thekson se kryesisht dominojnë klientët në bujqësi. Ai ka shtuar se si institucion mikrofinanciar i mbështesin bujqit në këtë drejtim për qasje në financa.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulëzim Rafuna, kërkon nga institucionet mikrofinanciare që t'i zbresin normat e interesit. "Kërkesa jonë është që të shihet mundësia që të ulen këto interesa, por për t'u ulur këto interesa duhet ulur me të gjitha institucionet mikrofinanciare dhe të shihet se cilat janë kërkesat e tyre dhe çfarë duhet të plotësojmë te kërkesat e tyre që ato të kenë riskun më të vogël. Duke ua ulur riskun si institucione publike institucioneve mikrofinanciare, padyshim që edhe ato ndikojnë në uljen e normës së interesit të kredive", thotë Rafuna.

Telekomi i Kosovës thotë se "Vala" ka modifikuar pakot, mohon se janë shtrenjtuar shërbimet

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Telekomi i Kosovës ka reaguar lidhur me lajmet që janë publikuar për shtrenjtim të pakove për shërbime të zërit dhe internetit.

Në njoftimin e Telekomit thuhet se "Vala", tashmë, duke ofruar shërbime me shpejtësi të lartë për qasje në internet përmes teknologjisë 4G+ dhe 5G, është kujdesur që konsumatorët e saj të kenë në dispozicion volum të

mjaftueshëm të internetit në pakot e tyre të reja (GB), prandaj edhe e ka rritur gati dyfish përmbytjen e secilës pako. "Titulli juaj 'Vala' shtrenjton çmimet e pakove për shërbime të zërit dhe internetit' lë përshtypjen e gabuar se 'Vala' kështu ka shtrenjtuar shërbimet e veta. 'Vala' tashmë duke ofruar shërbime me shpejtësi të lartë për qasje në internet përmes teknologjisë 4G+ dhe 5G, është

kujdesur që konsumatorët e saj të kenë në dispozicion volum të mjaftueshëm të internetit në pakot e tyre të reja (GB), prandaj edhe e ka rritur gati dyfish përmbytjen e secilës pako. Sipas matjeve tona, kjo qasje e jona është kuptuar drejt nga klientët tanë, sepse ka pasur edhe një sqarim të detajuar përcjellës nga ana jonë. Ne nuk kemi pranuar asnjë ankesë të tillë", thuhet në reagimin e Telekomit.



Semiopragmatizmi vital i Shkëlzen Ukëhaxhajt

- Izotopia e konceptit atdhetar në rrafshin diakronik
- Kontekstualizimi diakronik mbi motivin atdhetar

Shkëlzen Ukëhaxhaj është ndër shkrimtarët avangardues të letërsisë postmoderniste që me veprat e tij ka treguar unicitetin mbi tiparet e poezisë, që ngërthen në tematika të spikatura duke kaluar nga një kohë në një tjetër kohë, e format prolepsike determinojnë në të gjithë veprën. Pa nguruar mund ta quajmë veprën domosdoshmëri letrare për letërsinë kombëtare sepse stili, vargu dhe teknika përbëjnë poezinë e mirëfilltë dhe vargu i Ukëhaxhajt është i tillë. Bilateraliteti mes subjektit dhe nesh formëson një njësi pragmatike, sepse trajtohet ndjenja e përkthyer në dashuri, atdheu, sëmundja, historia, filozofia, psikologjia, arti, estetika e të bukurës e kështu ne vrojtojmë një kuantitet motivesh që nuk mund ta braktisim librin pa e lexuar.

“Kur fjala takon zemrën” evidenton në plotësinë e saj një polisemi mbi termin *zemër* prej së cilës shënjohen disa ndarje të emërtuara metaforikisht si kapituj, për të perceptuar situata imazhologjike, që ndodhin në sferën e jetës duke ndërtuar kujdesshëm letraritetin. Struktura formale respekton metrikën e saktë duke njësuar ndërthurjen e ritmit, rimës dhe figurave stilistike çka bën të mundur impaktin e pandashëm me lexuesin. Por, pse poeti i quan kapituj dhe i segmenton në tematika si në prozë!?

Retorika e shprehësisë në vepër na përcjell se poezitë e një kapitulli kanë në gjenezën e tyre motive të ndryshme si shkak i vijueshmërisë së mendimit mbi subjektivitetin e temës.

Në vepër vëmë re pozicionimin subjektiv të autorit, që e shtrin në një rrafsh shumëdimensional dhe si pararendës simotëruese janë disa poezi të botuara më parë, siç mund të citojmë poezinë “Poetëve”, ku nëpërmjet figurës së Don Kishotit, një ëndërrimtar dhe pasionant për ta kthyer kohën në një digresion të mundshëm, Ukëhaxhaj mbledh autorët nën ditëzën e shandandanëve për të vrojtuar një të vërtetë që mbetet thjesht një iluzion i haluçinacionuar.

“Enden poetët
Sipër kalit të Don Kishotit
Shekulli i ri u duket i largët
Ecni poet në ballë të kohës
Se Prugatori ju pret”

Esencialisht përcaktohen dy fuqi: shekulli si një element kohor, ku autorët gjenden në një dilemë përshtatjeje me mjedisin, ku kuturu humbin, çorientohen, mëkatojnë dhe



diapazoni alegerian nuk është gjë tjetër veçse katarsisi shpirtëror, për të shkëputur rëndesën e vetëdijes mbi ritmin e jetës, mbi konceptet ekzistencialiste antonimike mes qenësisë dhe hiçit, duke e abstruar deri në të ashtuquajturën ëndërr, që vijon në kohë dhe hapësira të ndryshme dhe që është trajtuar gjerësisht nga piko analitiket si nga Frojdi ashtu edhe Jungu arrijnë në një ide të përbashkët, që ëndrra ka një përmbytje psikike të fshehtë, që ndërthur linja problemore të akumuluar në rrjedhë realitetit për të shlyer gabimin apo mëkatit fillestar dhe elementi tjetër po aq i rëndësishëm është përshtatja. Le ta përqendrojmë vëmendjen te aspekti i parë. Ëndrra si një produkt patologjik përshin simptomën e disa kujtimeve që mund të rrinë të fjetura përkohësisht apo përjetësisht e Ukëhaxhaj e ka shprishur këtë linearitet duke u përqendruar te ndjenja atdhetare. Dëshiron të shëtisë, të buzëqesh e të ndiej kënaqësinë e jetës, por jo në Kosovë, jo në vatrën atërore, pasi shpirtplagosur kujton përcmimet, pabarazinë, robërinë e këtë e burgos brenda mendjes duke e ruajtur fuqishëm si një anomali e jetës pa të cilën nuk jeton jo se e dashuron, por fokusi i aktualitetit është rishikimi pas për të vijuar përpara. Ashtu siç thotë edhe Luçia Çezarini Martineti te vepra “Filozofia” ...ato mund të ndodhin brenda mendjes, janë shumë të ndërlikuara. Kur një fjalë hyn në tru, nuk është gjë tjetër veçse një varg tingujsh në kërkim të një domethënieje” e këtu vihet re vargëzimi i qëndisur me fjalë shpirti ‘atdhetarizmi’, është izotopi që krijon nivele në bazë të figurave të shquara të historisë siç mund të përmendim Adem Demaçin që lartohet mbi veprimet heroike përgjatë luftës.

Poezia fillon me:
“Ti, o Promethe
Të gjitha i thanë...
Për TY
Kush ishte e kush je,
Por, Ti
Në vendin tim do mbetesh
Gjitmonë, PROMETHE.”

Figura e Prometeut bëhet simbolikë e fuqishme rimarrjeje për autorin duke e analoguar me figurën e çmueshme të Adem Demaçit, i cili në formë koncentrike tejçon përbashkëtimin e protagonistit përbashkëtimin të egër të kohës. Vargu i parë na sjell një qasje të fortë ekspresive. Zëri prometeian simbolizon arsyen, përparimin, dritën që do të tejçojë në mendjen e njerzëve, t'i bëjë ata të vetëdijshëm ndaj veprimeve të tyre. Ndaj themi që dashuria e Prometeut për tokësorët vjen si pasojë e fisnikërisë që e karakterizon, ashtu si Ukëhaxhaj e parashpreh figurën e Demaçit strateg, që të afeksonuar nuk janë vetëm individët, por edhe rrugët, lagjet e çdo gjë që përmban rrethinën e këtij vendi duke e përqafuar në momentin e fundit fizik e dhe duke thënë “LAMTUMIRË BIR”, një shkëputje fizike e jo shpirtërore, pasi Demaçi frymon dhe gjendet kudo në shqiptari. Këshillat, vizionet dhe idealet janë bashkësia që sistemoi me kujdes si testament për ta praktikuar gjithnjë në rast nevojë e rreziku, formulë e saktësuar mbi rezultativen. Lëvizja referenciale është domosdoshmëri dhe nevojë letrare për të sinonimizuar personazhe që mishërojnë ide qofshin këto humaniste apo iluministe me personalitete nga Bota e Njëmendësisë, e autori nuk ndalët. Në rrjedhë të motivit atdhetar thur vargje për Jusuf Gërvallën, Zenun Gjocajt, Din Mehmetin, Dervish Shaqën duke ngritur një rrethnjë piramidale për të vërtetuar se

historia është shpirti i një populli dhe thurja e vargjeve nuk është gjë tjetër veçse përkthimi i një shpirti të dashuruar pas lirisë.

Një tjetër figurë e një rëndësie të veçantë është poema kushtuar Jusuf Gërvallës, personalitet i pikëparë në:

Personazh i lidhur me historinë Si mimetike letrare Si analogji teologjike Jusufi si diskurs prodhon historinë e personazhit letrar lidhur me fatin e tij çka sjell plotësi mbi aspektin kombëtar. Në vepër një ëndërr e Titos bëhet shkas e një lëvizje masive që trazon rehatinë e mizorit për një të drejtë kolektive, e personazhi ynë është fikcion i lidhur me një ambient konkret, që është Prishtina. Jusufi jeton e vepron në poemën e Ukëhaxhajt në disa shtresa intertekstuale siç e lartpërmendëm, ku peripecitë, drejtësia, angazhimi për një të drejtë përkon me Jusufin teologjik, sepse ai nuk u ndal përpara asgjëje e kjo solli për të tragjedi familjare për kauzën atdhetare.


Dhe qëllimi fisnik i tij,
Lëvizja si një trup bashkohet,
Në mes t'janarit '82-it
Me Kadrinë dhe Bardhoshin
Tashmë n'përjetësi.
Jusuf Gërvalla prezantohet me të tria gjinitë letrare epikë, lirikë

dhe dramatikë, ndonëse qëndërzimi është figura e mëmatdhisë, e cila koordinohet me rrafshet reale dhe irreale duke bërë të mundur kuptimësinë e termit letërsi. Vitet '70 ndihet fuqia e figurës së Jusufit që u angazhua me lëvizjen e jetës politike çka ngërthen dryna të shumtë kuptimor ndër vargje duke e njohur jo vetëm si gazetar, publicist, por edhe si prozator, dramaturg e poet që i këndon Atdheut duke u njësuar si shpirt i ndjeshëm lirik. Qasja e Gërvallës, Zenun Gjocajt, Din Mehmetit dhe shumë figurave e personaliteteve të shquara historiko-letrare na shëmbëlajnë me heronjtë e Rilindjes Kombëtare, madje edhe vetë Ukëhaxhaj personifikohet ‘rilindas’ i një kohe pegasike nga datimi i vetë rilindjes si periudhë letrare e deri te nënvizimi tipareve mbi mallin dhe dashurinë për atdheun. Në vepër gjejmë një novatorizëm mbi aspekte të shkrimit, ku “Biografi në vargje” larton figurën e Zenun Gjocajt atdhetarit të paepur, poetit dhe gjuhëtarit të paharruar. Vargje të tëra kushtimi për nder të tij i lexojmë me një vëmendje shumë të veçantë, por duam të ndalojmë të respekti që kishte për Adem Jasharin.

“Kështu vdekjes i the: Prit!
Sa t'kryej Epopenë në vargje,
Më duhen edhe ca ditë.
Më duhet të shkruaj për UÇK-
në,
Simbolin e lirisë
Për Adem Jasharin t'i them ca
vargje,
Si Fishta për Oso Kukën n'Lahutë
t'Malcisë.”

Tani eja!
Tash mbarova trilogjinë,
Vdekje, ty s'të frigohem,
Po të pres, oj armike”

Alegorikisht, stopohet vdekja për shkrimin e një epepeje që vijëzonte një figurë madhëshore, Adem Jashari, kryekomandanti legjendar i UÇK-së duke e krahasuar me Oso Kukën e Fishtës te e madhja




Lahutë e Malcisë, autori rimerr trimërinë, guximin dhe iniciativën për ndryshime thelbësore kombëtare për të mirën e përbashkët e kjo e shprehur në triologji, tri pjesë përbërëse që simbolikisht janë përcaktuese e fillimit të gjëmës, luftës, zhvillimit masakruar dhe përfundimit të një lumturie lotsjellëse, pasi humbja e të dashurve në luftë plagos shpirtin që shijon lirinë territoriale. Ukëhaxhaj shkel në terrenet rrëfyese të Zenunit duke e thirrur tashmë vdekjen, atë armike prej së cilës askush nuk mund të fshihet dhe ta largoj duke i thënë *"Tani eja!"*. 'Merr leje' Gjocajt nga vdekja për të bërë këtë triologji mbi Jasharin dhe se Ukëhaxhaj merr të njëjtin funksion për të vazhduar parabolizimin e së njëjtës njësi; të na njohë Zenunin përpara lexuesit, popullit duke e pyetur, duke e lavdëruar e diku-diku edhe duke aprovuar e mbështetur mbi fjalët *"Ku fjala krijohet me mjeshtëri, Aty fjala bëhej ligj, ligji përsëri liri"*

Duket sikur ka një marrëveshjeje mes vdekjes dhe Gjocajt që ky i fundit të mbante amanetin e tij shpirtëror për të përfunduar triologjinë.

Naimi, De Rada, P.Vasa e shumë rilindas të kohës formësonin idenë të shprehur në vargje dëshirën për liri, për një vend të çliruar nga robëria fizike e psikike e duke kërkuar respektin e një qytetari demokratik në një botë të lirë e analogjizmi vijohet me Ukëhaxhaj që përjeton një mall dhe dëshirë për Kosovën, Flamurin, etninë, traditën e se ëndrra e një ëndërrimtar mban gjallë shpresën e vradë nga situatat e dëgjua dhe të përjetuara në vend.

Thërret Ukëhaxhaj, thërret fuqishëm "O Adem Demaç" që unifikon revoltën e brendshme si rëndësë psikologjike dhe njëkohësisht qetësimi mbi 'heronj' të vlerës atdhetare; simbol për një vend të lirë, shpresëdhënëse dhe vetflijues për atdhe. E nëse i qasemi ngadalshëm figurës së Milosaos së dashuruar përjeton një moment lirik duke neglizhuar shkujdesëm detyrën atdhetare dhe një *deux ex machina* e rikthen atë në luftë dhe vdekja e tij nuk është dhimbje për ne, por një simpatizim për figurën e një heroi me fat të paracaktuar mbi tragjizmin e jetës e fokusi ynë është optimi mbi etapat për liri, ku edhe vepra jonë studimore kapërcen në stade sa të dashurisë si përcjellje e një uni të brendshëm aq edhe të epizmit mbi konceptin e atdhetarizmit. E ndjen autori dhimbjen e kudogjendshme në popull, në kulturë e në gjuhë dhe thur lavdishëm vargje për atë Kosovë që shpirti i qan. Larg saj fizikisht si rilindasit, por me një vëmendje të problemet filozofike si liria, lumturia, jeta e vdekja për atdhe të gërshetuara me aspekte të modernizmit duke e bërë veprën të krijoj linja paralele të tematikave të përdorura.

Në definicion, poezia "Thirrja e



çlirimtarit" përmyll unin atdhetar të autorit duke i kushtuar një vend të konsiderueshëm kësaj tematike. Kapitulli i dimensionit estetik ka një peshë të madhe rematike mbi qasjen e dashurisë si koncept universal, shumëdimensional duke radhatur autorë e siç e thotë edhe Zhak Lakan (Jacque Lacan) *"Lexuesi nuk merr pjesë në mënyrë pasive ndikimin që teksti letrar mund të ushtrojë mbi të, por përfshihet në një proces më aktiv, ose më tepër ndëraktiv"* sidomos kur përballemi me poezinë në totalitetin e saj dhe me titullin e poezisë "Ç'është poezia" duke përllogaritur kontekstualizimin e ndërtuar tashmë jo tematik, por natyrshëm rrjedhëse të vargjeve duke shkoqitur fonemat e duke formuar simfoninë dashurore, dehëse të zemrës e të shpirtit, ku të dy pranojnë edhe irrealen si mundësi shlodhjeje.

*"Do të kisha shkruar një përrallë
Për jetën të kisha menduar
Sikur të isha Ezopi..."*

Kumti poetik i Ukëhaxhaj është një udhëtim i gjatë që kërkon të gjej vendmbërritjen duke filluar me mistikët antikë e duke vijuar, kapërcyer në rryma të ndryshme letrare. Ezopi metaforikisht shënjon jo një autor, por periudhë të artë shkrimore, që i referohet poetit si indicie për një model përfaqësues në publik, endet për të gjetur vetveten mbi estetikën

*Sikur të isha Ezopi.
Po të isha Aristoteli,
Do të bëja një libër mbi përvojën.*

Antikiteti përbën bërthamën jetike për vijimin mbi unin poetik, thënë ndryshe bëhet simbol i oportunitizmit si vlerë e patjetërsueshme. Në radhët e shkrimtarëve përmendet i madhi Migjen dhe koncepti i mbinjeriut, ku ndodh një polemikë e fshehur ndër vargje.

*Kur në botë është luftë, për
mbinjeriun
Mund të jem Migjeni, Niçe
mund të jem unë.*

Le të përqendrohemi te Migjeni për të kuptuar psikologjinë e vargjeve të librit tonë, sepse në

to ka thellime filozofike dhe është e nevojshme një shqyrtim i shpejtë i stilit migjenian sepse ka pika takimi dhe largimi mes dy veprave.

Vëllimi "Vargje të lira" është i ndarë në gjashtë cikle e poezia e tij u bë novatore, shprehëse dhe pasqyron dhimbjet, ëndrrat dhe shpresat për të ardhmen duke u mbështetur te fuqia e vetvetes. E përfaqon teorinë niçiane duke mos besuar në një fuqi hyjnore, madje ai del në një revoltë të hapur ndaj mjerimit që nuk mund ta ndryshoj askush asgjë. Kësaj panorame i qaset Ukëhaxhaj në kohën për të cilën autori jeton, postmodernizmi shihet si një derivat i viteve '30 me të njëjtat problematika, shqetësime, ngërçe dhe revolta, të cilat vijnë si pasojë jo e mospasjes, por si pasojë e individit egocentrik mbi vëmendjen ndaj vetvetes të shpërndara këto shqetësime në kapituj poetik, respektivisht "Fjala e kapërturur nëpër pejzat e ndjenjave", "Meditime poetike", "Biografi e vargëzuar", "Përkushtime" dhe "Liria e plagosur".

Kostatojmë se poezia "Vëllai në shekullin 21" thyen traditën duke mos e njohur vëllanë, atë gjak që dikur ishin rritur në vatanin e tyre, kur varfëria dhe robëria i kishe kapluar dhe ata ndienin dashurinë, e ushqimi individual, vetjak përgjysmohej jo si detyrë, por si ushqim i një shpirti të pastër që sakrifikohe, e sot?

As robëri, as mjerim, por kryeneçsi dhe arrogancë. Pra, kemi një ndryshueshmëri midis dy kohëve migjeniane dhe ukëhaxhaj, sepse ato sendërtojnë të njëjtat shqetësime, ndonse më shqetësuese është e sotmja pasi mbizotëruese është egocentrizmi. E figura femërore?

Femra në të dyja veprat çmitizohet e vjen në trajtat e saj e zhveshur nga himnizimi i bukurisë dhe i mirësisë, qëndisja e detajeve bie si tipar i të dy autorëve. Migjeni te "Baladë qytetse" trajton problemin e psikikës së kësaj zonje që vallëzon në qytet krejt pa arsye, në vetminë e saj duke u rikthyer mbase në shtresëzimet e saj palimsesike, kujton rininë përballë figurës mashkullore.

...kur gjithë e saj në kreni

*Shpërthejshin n'aromë,
Kur ishte e njomë
Atëherë e dashurojshin shumë
zotni. E sot?*

Në kohën migjeniane personifikohet imazhi i saj dënues ndaj moralit të kohës, por është vetëm fillesa sepse novela të tjera trajtojnë këtë aspekt sikundër edhe incestin, që është vektor i rëndësishëm tematik, ndërsa Ukëhaxhaj përmban premtimin e aleancës postmoderniste duke u spikatur te erotizmi kontekstual *"Fati në kohën tonë"*, ku vashëza nuk e dëshiron, por e sheh si domosdoshmëri jetese, punë e cila i mundëson një jetë 'normale' pa mundime. Arrin dhe ta paralelizoj me profesione të tjera normale

*Por, ua them nga shpirti:
Veç atij që e fiton me djersë,
E puna ime me nderin e humbur,
Më duken si e njëjtë...*

Diskurisi i poezisë është pa ngjyresë emocionale dhe enumeracioni është tregues i veprimeve të vajzës ku tradhtia, dyfaqësia, paraja (pagesa për një natë erotike) dhe pushteti është aktualizues nënsipërfaqësor i shtresave të ndryshme shoqërore. Ndonjëherë, fati është destinues, paracaktues edhe i brezit pasardhës dhe protagonistja drejton lutje Zotit që fëmija i saj mos të ketë një fat si ajo. Pra, në bazë të ligjëritimit vrojtojmë dysinë e dy personaliteteve që janë binjakëzues i së njëjtës tematikë, aty ku e lë Migjeni e rimerr Ukëhaxhaj në të njëjtën stil e performancë shfaqjeje, por pa sforcime dhe kërshtëria e ndodhive shkallëzohet aq lirshëm sa që mendojmë që është e njëjta dorë që e shkruan. Ndërfutja e elementit të psikozës si poezi e bën veprën me një karakter shumëngjyrësh pasi personifikon çdo personazh që jetësohet aty. Ndihet lodhja, zbrazëtia, vetmia dhe bindja fetare nuk i udhëheq kah predikimeve, por humbet dhe ai besim që dikur i kishte mbajtur sot në qendër është vet personazhi, pra mbinjeriu migjenian.

Autori trajton dhe segmente të tjera si: dashuria dhe himnizimi i dashurisë së dy të rinjve, dashuria për vendlindjen, për

individët që janë në kapërcyell mes jetës dhe vdekjes dhe e gjithë kjo larushësi bëhet objekt studiimi mbi bazë të letraritetit.

Dashuria si një koordinatë e boshtit jetësor plotëson një nga tematikat e shfaqura në një vepër. Romeo dhe Zhulieta dy protagonistët e një pasioni mbi të patjetërsueshmen plotësojnë tragjizmin nëpërmjet veprimit dramatik. Udhëtojmë si lexues në veprat e Rilindjes jo vetëm shqiptare, por edhe europiane duke piketuar se e dëshirueshmja nuk arrihet, ka diçka që nuk arrin në definicion, 'akuzohet', fati i paracaktuar i tragjedisë për mosshikimin e së bukurës, e së mirës, e së dëshirueshmes.


Estetika zoton, tragjedia gozhdon duke ndërprerë rrjedhën e vazdimësisë mbi botën jetësore e vetëdija individuale krijon një kredo botë bashkudhëtimin e tyre në përtej had, që mund të jetë një dimension prugatoresk, ku shpëlarja e mëkateve është veprimi mbi vdekjen e parashikuar si rrisht guximtar mbi një përvojë të eksperimentueshme. Ky oaz vektorizohet me shpizën e ngrohtë të Ukëhaxhaj. Kurti dhe Petra zbresin në shkallët e thjeshtësisë dhe dashurojnë njëri-tjetrin në veprime thjeshtëzuese të padënueshme, por fati si një faktor sprovon me mosvazhdimësi të pasardhësit në të cilën Kurti dhe Petra e ndienin shumë e ngushëllimi ishte besimi në një fe monoteiste. Rrethi vicioz që ata kishin krijuar në monotoninë e tyre vrste, por mirësia dhe respekti për tjetrin u dha kurajo e shpresë për një të nesërme që sekretet janë të kofikueshme. Nga shpresa në rrënim e në poezinë "I dëshpëruar Lasgushi" homologohet më situatën e autorit, ka dashuruar, dashuron, por nuk ka një reagim ndaj këtij ngacmimi ndjesor dhe autori plogështohet në shpirt e jetën e quan të pakuptimtë pa praninë e së dashurës së tij.

*Në këtë vend kurrë s'do të mbijë
bari,
Lotët e mi e kanë tharë krejt,
I mërguar pa dashurinë time,
I dëshpëruar, marrëzisht do të
vdes.*

Në këtë botë të ndërtuar prej Shkëlzen Ukëhaxhaj konotohet shija estetike e zhanrit të poezisë. Letërsia e tij adreson vargje interaktive me historizmin e një teme të caktuar duke përfshirë lojën retrospektive si tagentgrupi më interesant brenda veprës. Në vetveten e tij pavarësisht shprehësisë mbi çdo motiv, opiumin është atdhedashuria.

*E madhërishmja UÇK- ja,
Kosovë sa keq po më dukesh,
Bijtë e Komitetit kishte,
Shtëpia ime e vorfnume,
Fuqi e ripërtërirë.
Kosovë e lirë...*

Emine BORIÇI
Lushnjë, Shqipëri
14 tetor 2024



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sylvinho: Çekia dhe Ukraina janë kundërshtarë të fortë, stadiumi plot na motivon

TIRANË, 8 NËNTOR - Pas publikimit të listës së Kombëtares së Shqipërisë, me emrat e grumbulluar për dy sfidat ndaj Çekisë dhe Ukrainës, të vlefshme për Ligën e Kombeve, trajneri Sylvinho doli të premtën në konferencën zyrtare për medie.

Trajneri brazilian foli për përzgjedhjen e lojtarëve, objektivat e skuadrës për këto dy ndeshje, ndërsa tregoi se si qëndron situata me lojtarët e vijës së sulmit. Sylvinho vlerësoi lojtarët e ardhur nga ekipi U-21, teksa u rikthye edhe një herë të ndeshja me Çekinë. I pyetur nga gazetarët nëse motivohet nga stadiumi plot për ndeshjen me Çekinë, teknikun brazilian u shpreh se kjo është diçka e mrekullueshme.

Lista me 28 lojtarë dhe vendi i parë si objektiv?

Sylvinho: Kemi marrë 28 lojtarë, por shpjegohet lehtë. Kemi 5 lojtarë me kartonë të verdhë, dy ndeshje në shtëpi, nuk kemi udhëtime, nuk ka avion, kemi qendër të mirë këtu. Kemi gjithçka këtu. Vendosëm të merrnim maksimumin e mundshëm. Përtej atyre me të verdhë, kemi 3 lojtarë që janë në situatë "gri". Jemi vazhdimisht në diskutim. Kemi folur me doktorët, me klubet dhe Stesinën. Duhet të shohim situatën e Kumbullës, Manajt dhe Bares. Duhet të kuptojmë akoma më mirë situatën e tyre. Kemi vendosur që t'i thërrasim dhe të shohim si janë, nëse janë në gjendje të luajnë apo jo. Padyshim si të gjithë mund të dalim të parët, por në këtë grup mund të ndodhë gjithçka. Janë katër Kombëtare që kanë luajtur në Evropian, ka cilësi, janë lojtarë që luajnë në Bundesligë, Premierë Ligë, janë të fortë. Gjeorgjia na mundi këtu, ne shkuam atje dhe fituam. Kemi avantazhin që luajmë në shtëpi të dy ndeshjet, është një avantazh i vogël, por i mirë.

Situata e sulmit?

Sylvinho: Një dhimbje kokë për një trajner është gjithmonë e mirë. Çdo trajner dëshiron të ketë hapësirë dhe mundësi për lojtarë të ndryshëm. Ky është një moment i rëndësishëm për Kombëtaren, për vendin. Të kesh një grup të tillë dhe të mbërrish në fund i gjallë është i rëndësishëm. Ukraina ka lojtarë të mirë, Gjeorgjia ka bërë një Evropian të mirë dhe Çekia është ekip i fortë është vendi i parë në grup. Në këtë moment Manaj nuk luan prej dy javësh. Ka shënuar dhe është dëmtuar, nuk luan prej 14 ditësh. Bare ka

marrë një goditje në gju dhe nuk luan prej 13 ditësh. Ne sa më shumë lojtarë të fortë të kemi, na jep shtysë të shkojmë para. Muçi është në një moment të mirë, ka shënuar në tre ndeshje radhazi, jam i lumtur për të dhe për të tjerë, Bajrami po bën shumë mirë te Rangers. Muçin një muaj më parë e kam vizituar, askush nuk e di, nuk ishte moment i mirë për të. Kjo është puna, të dalim e të shohim, t'i takojmë, të pimë kafe, ta dëgjojmë, ta përqafojmë. Janë momente të vështira. Një transferim si i Muçit është i vështirë se ndryshojnë shumë gjëra, gjuha, zakonet. Për mua dhimbja e kokës është shumë e mirë, sa më shumë lojtarë në formë të kemi, aq më mirë.

A ishte Cristian Shpendi opsion?

Sylvinho: Këtu në fakt po ndodh diçka e bukur me Kombëtaren se po marrim lojtarë të mirë nga U-21, si Mario Mitaj, Feta Fetaj, Simon Simoni, ashtu dhe Pajaziti i cili fatkeqësisht duhet të jetë jashtë fushave për 5 javë. Nuk mendoj që është gjë e duhur t'i marrim lojtarët vetëm sepse duhet t'i thërrasim. Indrit Tuci luajti me Spartën, Manaj është në dyshim, por nuk duhet të merrnim Shpendin vetëm për ta aktivizuar. Është lojtar shumë i mirë, i fortë në zonë. Janë dy vëllezër, kanë cilësi të ndryshme dhe ndoshta i marrim të dy në momentin që mund të ndodhë. Rikujtoj edhe një lojtar tjetër Medon Berisha, i cili ka 50 ditë jashtë fushave pasi pati rindërtim, por shpresoj të rikthehet shpejt se është një lojtar i rëndësishëm.

Lojtarët?

Sylvinho: Nuk di të them momentalisht, di çfarë t'iu them lojtarëve të mi. Kemi një grup të vështirë kemi 5 ditë përgatitje. Duhet të kuptojmë se çfarë duhet të bëjmë në fushë. Ajo që dua të sigurojë është që do të luajmë gjithmonë me shpirt dhe zemër. Asnjëherë nuk na ka munguar shpirti dhe zemra në fushë.

Uzuni dhe Muçi vijjnë në një formë shumë të mirë?

Sylvinho: Duhet të kuptojmë situatën e Manajt. Ta shohim nëse do ia dalë të jetë i gatshëm për ndeshjet. Kam dëgjuar dhe folur me të, të shohim si vjen dhe nëse ia del të bëhet gati. Kemi Dakun të skuadërimit, Tuci bëri një ndeshje shumë të mirë. Por duhet të punojmë pa 2-3 lojtarë që janë pikë referimi. Muçin dhe Uzunin duhet t'i provojmë. Uzuni është një sulmues i dytë, por Muçi është



një lojtar ofensivë i cili luan në krahun e majtë, por në fund ka bërë edhe të djathtin te Beshiktash. Te ne nga cilësitë dhe karakteristikat e lojtarëve është pak më ndryshe. Duhet kuptuar nëse mund t'i përdorim në ndeshje sipas nevojave që kemi, janë 2 apo edhe një i tretë që mund të bëjë sulmuesin kur nuk kemi një numër 9.

Feta Fetaj?

Sylvinho: Ne kemi marrë shumë lojtarë nga Kombëtarja U-21. Fetaj, Mitaj, Bajrami, Simoni, Asllani që është shumë i ri, Pajaziti, Medon Berisha, Fetaj, Shpendi, Çuni, janë lojtarë shumë të mirë. Mund të na shpërbejnë shumë për të ardhmen, padyshim. Jam shumë i lumtur me lojtarët që kanë ardhur nga Kombëtarja U-21, kanë bërë shumë mirë. Ne mund të mendojmë që këta lojtarë mund të bëhen nesër titullar, është një proces. Unë jam shumë i lumtur për lojtarin që kemi marrë. Janë lojtarë që na përgjigjen shumë mirë në ekipin e parë. Është një skuadër e re, që po bën mirë. Ne jemi munduar të krijojmë një ekuilibër mes lojtarëve të rinj dhe me eksperiencë. Kemi një Kombëtare të re në moshë.

Kundërshtarët?

Sylvinho: Duhet të kemi parasysh kundërshtarët që pësojnë pak. Gjeorgjia është një skuadër e fortë taktikisht, ashtu si Çekia dhe Ukraina. Ne kemi bërë një rrugëtim shumë të rëndësishëm në dy vitet e fundit. Ju rikujtoj që edhe ne jemi pak a shumë si ata njësoj, por edhe ne si ekip nuk pësojmë shumë gola. Nuk janë kundërshtarë që në 15 minutat e para t'iu shënojmë 2 gola. Është e rëndësishme të qëndrojmë në garë dhe kjo na motivon. Kemi pasur punë të vështirë dhe nuk është e lehtë të marrim 6 pikë deri tani. Duhet t'i falënderoj lojtarët dhe stafin, duhet të përmirësohemi, na

presin dy kundërshtarë dhe ndeshje të vështira.

Çekia?

Sylvinho: A ka qenë e lehtë për Çekinë ndaj nesh? Jo! A ka qenë e lehtë për ne të luajmë kundër tyre? Jo! Ajo që dua të them është se ndoshta ne se kemi kuptuar që të luash me Çekinë është e vështirë. Kanë lojtarë të fortë. Tani njerëzit e dinë kush është Bajrami. Para një viti, kush e dinte kush ishte Mario Mitaj? Asllani tani njihet. Ramadani, i fortë. Tashmë na njohin, kanë filluar të studiojnë Shqipërinë. Jemi përmirësuar shumë. Të luash në Pragë ndaj Çekisë është e vështirë. Për ne është krenari që jemi gjallë nga këto ndeshje dhe jemi përballur me Çekinë që nga ana tjetër thotë se Shqipëria është një ekip i ashpër, ka lojtarë si Bajrami etj. Ata kanë bërë një ndryshim të trajnerit, është një skuadër fizikisht e fortë. Chory është lojtar i fortë me topin në këmbë, shumë i fortë, e vështirë të luash kundër tij. Më pas, Sulc, ka shënuar ndaj Ukrainës, mesfushor qendre, trekuartist, luan edhe si sulmues anësor. Provod nga njëra anë, Cerny nga ana tjetër, të dy sulmues anësorë të gjatë, të fortë, të vështirë për t'u përballur. Ne duhet të zhvillojmë një ndeshje të mirë nëse duam të fitojmë. Jemi krenarë që jemi pothuajse të barabartë me Çekinë, që tashmë dikush atje thotë se ndeshja me Shqipërinë është e vështirë. Në Evropian na kanë uruar për punën tonë, të lojtarëve, të Federatës. Skuadër e bukur, e organizuar, pyesnin ku i kemi gjetur këta lojtarë. Humbëm me Spanjën, ama në atë grup ishim në lojë deri në momentin e fundit për të ecur më tej. Është një rrugëtim, nuk mund të themi që shkojmë nesër në Wembley dhe mundim Anglinë 4-0. Duhet të ecim para. Për sa i përket ndeshjes në shtëpi, nuk mendoj se ishte fat,

kemi bërë ndeshje të bukur. Fusha është ajo që vendos. Njëherë hyn topi, njëherë jo. Është e vështirë, por kemi bërë një rrugëtim të rëndësishëm dhe duhet të përmirësohemi akoma.

Stadiumi "sold out", presion apo motivim? – Për ne është shumë e bukur të luash para 22 mijë tifozëve. Është motivim shtesë. Në fushë hyn, luan futboll. Është argëtim, është bukur dhe duhet shfrytëzuar, atmosfera është shumë e bukur. Ka një avantazh të vogël, të bukur, që duhet ta shfrytëzojmë. Të hysh në fushë me stadiumin plot është emocion i madh për ne. Do punojmë 5 ditë dhe do hyjmë në fushë për të bërë ndeshje të bukura. Nëse vërtetë duam t'i afrohem objektivit tonë, duhet të zhvillojmë një ndeshje afër 100% – it.

A ka Sylvinho një plan B dhe forma e Asllanit në Kombëtare?

Sylvinho: Ne kemi përmbytur ndeshjen ndaj Ukrainës. Ukraina është e fortë, është e vështirë. Nëse t'i bën një gabim, sa ndeshje mund të përmbysen? Sa ndeshje janë përmbytur në Evropian apo Botëror? Nuk po flas për Kombëtaren shqiptare, por në përgjithësi, kur pëson, ulet mundësia për të përmbytur ndeshjen. Futbollit është i tillë, është i vështirë. Për Asllanin, nuk jam dakord. Me ne luan 90 minuta, shënon, tashmë ka 2 gola. Është lojtar i ri, teknik dhe po zhvillohet shumë edhe në aspektin fizik dhe taktik. Në Kombëtaren tonë, Asllani po bën shumë mirë. Se di nëse jep 70 apo 80 %, por te ne luan 90 minuta, është titullar i skuadrës. Ka bërë një rrugëtim të plotë në kualifikueset e Euro 2024 dhe një Evropian shumë të mirë sipas meje dhe po luan mirë. Sipas nesh, po punon shumë mirë. Sa mund të rritet? Me siguri shumë, por sipas nesh po bën shumë mirë.

Lista e futbollistëve:

Thomas Strakosha, Elhan Kastrati, Alen Sherri, Simon Simoni, Ivan Balliu, Elseid Hysaj, Mario Mitaj, Andi Hadroj, Ardian Ismajli, Berat Gjimeshi, Arlind Ajeti, Marash Kumbulla, Enea Mihaj, Ylber Ramadani, Kristjan Asllani, Amir Abrashi, Qazim Laçi, Feta Fetaj, Jasir Asani, Taulant Seferi, Nedim Bajrami, Arbër Hoxha, Keidi Bare, Ernest Muçi, Indrit Tuci, Mirlind Daku, Myrto Uzuni, Rey Manaj.

FBK-ja të hënën paraqet përzgjedhësin e ri

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se do të organizojë konferencë për medie të hënën nga ora 11:00 në zyrat e FBK-së. Në këtë konferencë do të paraqitet përzgjedhësi i ri, Jean-Denys Choulet. "Trajneri

me shumë përvojë ndërkombëtare do t'i shpalosë synimet me 'Dardanët', që në muajin nëntor do të zhvillojnë dy ndeshje si mysafirë. Choulet do të japë detaje për grumbullimin që nis më 12 nëntor në Prishtinë, thuhet në

njoftimin e FBK-së. "Dardanët" më 21 nëntor do të ndeshen me Zvicrën dhe më 24 me Irlandën. Ndeshjet zhvillohen në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2027. Kosova ka një fitore dhe një

humbje. Sfidat e fundit do të jenë në shkurt të vitit të ardhshëm, kur do t'i presim Zvicrën dhe Azerbajxhanin. Jean-Denys Choulet ka nënshkruar kontratë trevjeçare me Federatën e Basketbollit të Kosovës.



Përballja e finalistëve të 'play-off'-it

SUHAREKË, 8 NËNTOR - Fundjava pritet të sjellë superndeshje në elitën e basketbollit, ku zhvillohet xhiroja e nëntë e ProCredit Superligës. Dueli i parë dhe derbi i kësaj xhiro zhvillohet ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Trepçës, apo finalistëve të "play-off"-it të edicionit të kaluar, ku "Xehetarët" kishin fituar 3:2 në serinë finale. Therandasit kanë pesë fitore e tri humbje, ndërsa mitrovicasit gjashtë fitore e dy humbje, andaj pritet një takim mjaft interesant. Në duelin e parë të këtij edicioni



fituan mitrovicasit 77:67. Përballje mjaft interesante shihet ajo ndërmjet Vëllaznimit dhe Bashkimit. Kuqezinjtë kanë tri fitore e pesë humbje, ndërsa prizrenasit shtatë fitore e një humbje. Humbjen e vetme e pësuan nga Trepça, fundjavën e kaluar. Sfidën e parë e fituan prizrenasit 72:51. Të dielën do

të zhvillohet takimi ndërmjet Proton Cable Prizrenit dhe Pejës. Prizrenasit kanë dy fitore e gjashtë humbje, ndërsa pejanët tri fitore e pesë humbje, andaj është një ndeshje shumë e rëndësishme për të dy skuadrat. Ndeshja Bora - Sigal Prishtina është shtyrë me kërkesë të Sigal Prishtinës.

SUPERLIGA - Java 9

Të shtunën takohen:
17:00 Golden Eagle Ylli - Trepça
19:00 Vëllaznimi - Bashkimi

Të dielën takohen:
19:00 Proton Cable Prizreni - Peja

Zhegrova: Më pëlqen vërtet Milani

LILLE, 8 NËNTOR - Sulmuesi Edon Zhegrova e ka lënë të hapur mundësinë për të kaluar në Serinë A, duke shprehur dashurinë ndaj AC Milanit. Pas përballjes me Juventusin, ylli i Kosovës ka dhënë një intervistë për gazetarin italian Ginaluca di Marzio, ndër të tjera, është pyetur edhe për transferimin e mundshëm në Itali. "Më pëlqen futbolli italian. Gjithmonë i kam përcjellë klubet e mëdha si Milan, gjithashtu i shikoj ndeshjet e Juventusit. Në Kosovë pastaj ka shumë tifozë të Milanit, Interit e Juves. Unë në Serinë A një ditë? Pse jo? Më pëlqen vërtet Milani", ka thënë ai.

Zhegrova është shprehur shumë i lumtur me pikën që Lille e ka fituar ndaj Juventusit. "Një skuadër si Lille zhvilloi një ndeshje të shkëlqyer. Ky ishte çelësi. Gjithmonë dua ta ndihmoj



skuadrën me ndonjë asistim apo gol". Juventus është klub gjigant me lojtarë fantastikë. E pamë sa e fuqishme është si skuadër. Në fund një barazim ishte i drejtë sepse u përballëm me një skuadër të fortë. Lille u mbrojt në pjesën e dytë? Ndonjëherë varet se si

shkon ndeshja. Kur kundërshtari të dominon në posedim, duhet të mbrohesh mirë. Ndonjëherë nuk mund të bësh asgjë për këtë situatë", ka thënë Zhegrova. Ndërkohë, Juventus është thënë se e ka prioritet transferimin e Zhegrovës.

SHKURT

Milwaukee rikthehet te fitorja, triumfojnë edhe Minnesota e San Antonio

Ekipi i Milwaukeees fitoi me rezultat 123-100 ndaj Utah Jazzit, sukcesi i dytë sezonal, sfidë ku shkëlqeu dyshja Lillard - Antetokounmpo, që së bashku realizuan 65 pikë. Sukses që largon ekipin e Bucksit nga fundi i renditjes në Lindje. Fitore të rëndësishme korri skuadra e Minnesotas, që mposhti me rezultat 135-119 Chicagon jashtë fushës. Të gjithë titullarët e Minnesotas realizuan mbi 10 pikë, ku më i miri ishte Anthony Edwards, autor i 33 pikëve. Skuadra e San Antonio Spursit fitoi me rezultat 118-105 ndaj Portlandit, ndeshje ku kolektiviteti i vendësve bëri dallimin. Plot tetë lojtarë të Spursit realizuan mbi 10 pikë, ndërsa te Portlandi mungoi lojtari lider. Rezultatet: Chicago-Minnesota (119-135), Milwaukee-Utah Jazz (123-100), San Antonio-Portland (118-105).

Hamilton: Nuk doja ta mbyllja karrierën pa pilotuar me Ferrarin

Pas dy muajsh piloti britanik Lewis Hamilton do të jetë pjesë e Ferrarit, duke u larguar nga Mercedesi. Makina italiane po lufton për titullin për konstruktorë dhe këtë sezon ka arritur pesë fitore në botërorin e Formulës 1, sinjal ky pozitiv për shtat herë kampionin e botës. Këto fitore janë një motivim më shumë për të për ta fituar titullin e tetë, ndërkohë që duket se edhe vetë piloti mezi pret të provojë një "kokëkuqe". "Ëndrra e çdo piloti është të garojë me një Ferrari. Nuk doja të shkoja në fund të karrierës sime duke pasur një peng të madh, që nuk kisha pilotuar një Ferrari", ka thënë Hamiltoni. "Unë nuk e di kur do të përfundojë karriera ime, por kam një plan shumë të qartë përpara. Shpresoj që përvoja të më ndihmojë te Ferrari dhe së bashku mund të formojmë një skuadër të fortë, që të fitojë dhe të arrijë objektivat e saj", u shpreh Hamiltoni.

Trajneri i Gjermanisë: Duam të shkojmë në finalen e Ligës së Kombeve

Javën e ardhshme rikthehen ndeshjet e ekipeve kombëtare, që do të luajnë dy sfidat e fundit në Ligën e Kombeve. Kombëtarja gjermane do të përballlet me Bosnjë-Hercegovinën dhe Hungarinë, teksa i mjafton një fitore për ta siguruar vendin e parë. Trajneri i Gjermanisë, Julian Nagelsmann, ka komentuar situatën në prag të sfidës ndaj boshnjakëve: "Ne duam ta fitojmë grupin tonë në Ligën e Kombeve, nëse është e mundur para tifozëve tanë në ndeshjen në shtëpi në Freiburg". "Kualifikimi në 'Final Four' për herë të parë është një objektivi i rëndësishëm për ne, duke pasur parasysh Kupën e Botës 2026, eventin e madh që kemi përpara. Ndaj këto ndeshje dhe kalimi në finalen e Ligës së Kombeve janë një test i mirë", ka thënë Nagelsmann. Më tej, trajneri i gjermanëve ka shtuar: "Jemi të vetëdijshëm se kemi një ekip të fortë. Mund të bëjmë disa ndryshime në disa pozicione për shkak të dëmtimeve, por kjo s'na tremb, pasi jemi të karikuar për të bërë mirë".

Reali synon transferimin e Wirtzit

Pavarësisht se kanë yje si Vinicius Juinor, Jude Bellingham e Kylian Mbappe në skuadër, Real Madrid kërkon të transferojnë një tjetër yll të

futbollit botëror. Bëhet fjalë për "fantazistin" e Bayer Leverkusenit, Florian Wirtz me 21-vjeçarin gjerman, që shihet në "Bernabeu" si zëvendësuesi

perfekt i Luka Modriqit, i cili me shumë gjasë do ta mbyllë aventurën te "Los Blancos" në fund të këtij edicioni. Sipas raportimeve më të fundit të

medieve spanjolle, presidenti Florentino Perez deri më tani nuk ka ndër mend të paguajë 150 milionë eurot e kërkuara nga "Aspirinat" gjermane,

megjithatë në rast se transferimi kryhet gjatë merkato së verës, në radhët e madrenëve pritet largimi i një prej talenteve të sulmit, Rodrygo ose Arda Guler.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ARKA” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Artan Kastrati ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810072215 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ARKA” D.O.O. Gjilan, Artan Kastrati donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810072215 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “ARKA” L.L.C. with headquarters Gjilan, Artan Kastrati has come to the decision to quit its business: 810072215 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Thirrja për aplikim
(DHËNJE TË OFERTËS)**

“XEKRRRI” SH.P.K. me Numer Unik.Biz: 812190502 me seli te biznesit në Adresa: Fsh Orllan pn **komuna Podujeve**, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

Nr Prokurimit 01/2024 dates 09.11.2024

1. Traktor 90 hp 4x4 me kabine dhe klime
2. Pllug 3 rendor,
3. Mikser per ushqimin e kafsheve 2.5 ton,
4. Shprendarese e plehut artificial 1000 l,
5. Kose bari,
6. Sperkatese 500 l,
7. Valak me gjemba,
8. Makine per mbjellje te patateve,
9. Freze dheu,
10. Pijatore terheqse 28 disqe,
11. Energjia Solare 3kw .

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek “XEKRRRI “SH.P.K. pronar **Enver Zeka** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë **(5 ditë nga data e publikimit)**

Afati i dorezimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: Fsh Orllan pn **komuna Podujeve**
Për Informata Shtesë tel: +38345519184

dhe në email adresën: zekaenvershpk@gmail.com

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Domenik Gjoka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Burim Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Jetmir Malushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

